



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI I SHKODRËS "LUIGJ GURAKUQI"  
REKTORI

Nr. 4092/prot.

12

Shkodër, më 11.12.2018

**NJOFTIM**

Njoftohen të gjithë të interesuarit se në Universitetin e Shkodrës "Luigj Gurakuqi" shpallet konkursi për katër vende të lira pune, si më poshtë vijon :

III. Fakulteti i Shkencave të Natyrës, Departamenti i Biologjisë dhe kimisë, për pozicionin Lektor/e me kohë të plotë.

**Kandidatët duhet të plotësojnë këto kritere specifike :**

1. Të kenë kryer të gjitha ciklet e shkollimit me kohë të plotë në një nga specialitetet e "Kimisë".
2. Të kenë kryer ciklin e parë të studimeve në sistemin me kohë të plotë, në një nga programet e studimit të "Kimisë" me notë mesatare mbi 8.5.
3. Të kenë kryer ciklin e dytë të studimeve me kohë të plotë me diplomë "Master i Shkencave" me drejtim Kimi me notë mesatare mbi 8.5.
4. Të kenë kryer ciklin e dytë të studimeve me kohë të plotë me diplomë "Master i Shkencave" ose "DIND" (300 ECTS) në profilin "Kimi", me notë mesatare jo më të ulët se 8.5. Për të diplomuarit jashtë vendit kërkohet certifikata e njohjes nga MASR.
5. Të kenë të mbrojtur një nga gjuhët e huaja të BE-së me notë jo më të ulët se 8 ose të ketë mbrojtur një nga pesë gjuhët e njohura nga Kuadri i Përbashkët Evropian i Referencave për gjuhët në nivelin C1.
7. Preferohet të kenë titull akademik apo gradë shkencore "Doktor" në kimi.

**Kandidatët për pedagogë duhet të plotësojnë këto kritere të përgjithshme :**

1. Të kenë zotësi të plotë veprimi, aftësi të punës në grup, aftësi komunikimi profesional.
2. Të mos jenë të dënuar me vendim të formës së prerë nga gjykata.
3. Të mos jetë marrë ndaj tyre masa disiplinore e largimit nga puna.
4. Të mos jenë larguar nga USH "L.Gurakuqi" pa miratimin e këtij të fundit.
5. Të mos kenë prishur në mënyrë publike imazhin e USH "L.Gurakuqi".
6. Të mos kenë lidhje familjare (bashkëshort/bashkjetues, bir, bijë dhe fëmijët e tyre), gjinie (prindër, motër e vëlla dhe fëmijët e tyre, emtë a ungj) apo krushqie (prind, fëmijë, vëlla/motër i/e bashkëshortit/es dhe bashkëshort/bashkëjetues i fëmijëve) me punonjës egzistues brenda të njëjtes njësi bazë apo ndihmëse ku kërkohet të punësohen.



